



Njoftim per shtyp

15 November 2011

Prezantohet mbështetja ndërkombëtare për ruajtjen e biodiversitetit në Shqipëri

Tiranë, 15 nëntor – Përfaqësues të qeverisë shqiptare dhe asaj italiane, pushtetit vendor, organizatave ndërkombëtare, donatorë, universitetet, shoqërisë civile dhe medias u mblodhën për të prezantuar nisjen e një projekti të fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe mbështetje për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri . Ky event është organizuar nga Ambasada Italiane në Tiranë dhe Ministria shqiptare e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), me mbështetjen e IUCN(Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës).

Gjatë këtij aktiviteti u paraqit projekti 2-vjecar i cili do të mbështesë stafin kombëtar dhe lokal të Ministrisë dhe do të kontribuojë në zhvillimin e kapaciteteve teknike, planifikimin dhe zbatimin e këtyre institucioneve. Objektivi kryesor i projektit është të forcojë kapacitetet teknike dhe zbatuese në proceset e planifikimit sistematik dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura si në zyrat qendrore ashtu edhe në ato lokale të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

"IUCN është e angazhuar për forcimin e efikasitetit të zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe të sigurojë standardet globale të mbrojtjes dhe menaxhimit të zonës nëpërmjet rrjetit të saj të ekspertëve", deklaroi **Z. Boris Erg, Drejtor i Zyrës së IUCN-së, Programi për Evropën Juglindore**. "Përmirësimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura do të ndihmojë në ruajtjen e paçmuar të biodiversitetit në Shqipëri, por edhe të vëndosë baza solide për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve lokale ".

Projekti do të kontribuojë gjithashtu në përmirësimin e kushteve social-ekonomike lokale nëpërmjet promovimit të aktiviteteve alternative të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik për popullsinë lokale që banojnë në afërsi ose brenda dy zonave të përzgjedhura "të mbrojtura" Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe Velipoje. Këto zona të përzgjedhura ofrojnë shërbime të mëdha ekosistemit për popullsinë, për shembull, ato garantojnë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ujit dhe për të parandaluar erozionin bregdetar. Të dy këto zona janë edhe në kufi me dy vende të tjera dhe dialogu për ruajtjen e biodiversitetit midis Shqipërisë dhe këtyre vendeve mund të çojë në një qasje sistematike për ruajtjen. Zbatimi i projektit do të mbështetet nga dy partnerët lokalë: Instituti për Ruajtjen e Natyrës të Shqipërisë - INCA, dhe Mbrojtja e Mjedisit Natyror në Shqipëri - PPNEA.

Për informacion të mëtejshëm:

Aleksandra Nestic, Zyrtar Operacioneve, Zyra IUCN Programit për Evropën Juglindore
Tel: +381-11-2272-411, Mobile: +381-63-357-407, aleksandra.nestic@iucn.org, Web:
<http://www.iucn.org/southeasterneurope>

Informacion :

Të Dhënat e projektit: Projekti, i financuar nga zyra për Bashkëpunimin Italian / Ministria Italiane e Punëve të Jashtme, do të zbatohet nga IUCN (Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës) Zyra e Programit për Evropën Juglindore gjatë periudhës shtator 2011-shtator 2013. Përfituesit e projektit do të jetë institucionet në nivel kombëtar, global dhe nivel lokal (njerëzit që jetojnë në këto zona dhe qëndrimi i tyre është i lidhur ngushtësisht me zonat e mbrojtura dhe përdorimin e burimeve natyrore). Kontributi financiar i Kooperacionit Italian - DGCS për këtë projekt është 2,215,191 Euro.

Historiku i Projektit: Projekti pason një deklaratë të miratuar në Shkodër (5-6 dhjetor 2003) nga Konferenca Ndërkombëtare "Politikat e Mjedisit: Instrumente dhe Metoda" të organizuar në kuadër të iniciativave shkencore e Ambasadës Italiane. Një nga 7 rekomandimet kryesore drejtuar institucioneve shqiptare ishte krijimi i zonave të reja të mbrojtura dhe përmirësimi i menaxhimit të atyre ekzistuese, duke siguruar mbrojtjen e tyre dhe menaxhimin më të mirë të të ardhurave që gjenerohen pa kompromentuar ruajtjen e tyre. Ministria shqiptare ka nevojë për forcimin profesional të stafit të saj për të:

- Rritur planifikimin e zonave të mbrojtura dhe kapacitetet e menaxhimit mjedisor;
- Adresuar prioritetet qeveritare kombëtare dhe nën-kombëtare për mjedisin;
- Përmirësuar kapacitetet kombëtare në ruajtjen e biodiversitetit.

Në këtë kuadër, Projekti është mbështetës i detyrimeve shtetërore që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare, direktivat e BE-së dhe Strategjisë Kombëtare për Biodiversitetin dhe Planin e Veprimit.

Objektivat e projektit: Objektivi i përgjithshëm i propozuar i projektit është që të forcojë zyrat qendrore dhe lokale të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në zhvillimin teknik, planifikimin dhe zbatimin e kapaciteteve për planifikimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura. Duke promovuar qasje inovative të menaxhimit të zonave të mbrojtura, që gjithashtu nënkupton përkthimin e parimeve të ekonomisë së ekosistemeve dhe biodiversitetit në praktikë, ky projekt do të demonstrojnë një gamë të gjerë të përfitimeve që komunitetet lokale dhe më gjerë mund të gëzojnë nga mirë-funksionimi dhe mbrojtja e ekosistemeve. Projekti do të kontribuojë gjithashtu në një përmirësim të kushteve social-ekonomike lokale nëpërmjet promovimit të aktiviteteve alternative të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik për popullsinë lokale që banon në afërsi ose brenda dy zonave të projektit të zgjedhura të mbrojtura: Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe Velipoje.

Rezultatet e projektit: (1) Një grup të mjeteve teknike dhe metodologjike për menaxhimin efektiv të ekosistemeve, zonave të mbrojtura Velipojë dhe Shebenik-Jabllanicës është zhvilluar vazhdimisht me qasjen e ekosistemit. (2) procedura të përshtatshme teknike dhe kapacitetet infrastrukurore të Ministrisë dhe administratës lokale janë rritur. (3) janë përgatitur planet e menaxhimit për zonën e mbrojtur Velipojë dhe Shebenik-Jabllanicës. Planet e menaxhimit do të zhvillohen sipas udhëzimeve planifikimeve dhe menaxhimit të IUCN WCPA (Komisioni Botëror për Zonat e Mbrojtura) dhe do të trajtojnë të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm (sociale, institucionale, ekonomike dhe mjedisore) në mënyrë të integruar, me qëllimin përfundimtar të promovimit të ruajtjes së biodiversitetit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, si dhe nxitjen e një zhvillimit social-ekonomik harmonik. (4) Një manual udhëzues për përgatitjen e planeve të menaxhimit pjesëmarrës të zonave të mbrojtura është e përgatitur sipas planeve të menaxhimit dhe standarteve të WCPA si dhe qasjes së ekosistemit të nxitura nga Projekti. (5) keto 2 zona Velipojë dhe Shebenik-Jabllanicës bëhen më efektive dhe njësitë zhvillimit si veprimet e para të identifikuara në planet e tyre të menaxhimit do të zbatohen.

Rreth IUCN

IUCN, Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, ndihmon botën të gjejë zgjidhje pragmatike për sfidat më të ngutshme të mjedisit dhe zhvillimit. IUCN punon mbi biodiversitetin, ndryshimin e klimës, energjinë, jetesën e njeriut dhe gjelbërimin e ekonomisë botërore duke mbështetur kërkimet shkencore, menaxhimin e projekteve në terren në të gjithë botën, dhe sjelljen e qeverive, OJQ-vë, OKB-së dhe kompanive që së bashku të zhvillojnë politika, ligje dhe praktikat më të mira. IUCN është organizata më e vjetër dhe më e madhe globale në botë e mjedisit, me anëtarë të më shumë se 1.000 qeverive dhe OJQ-ve dhe pothuajse 11.000 ekspertë vullnetarë në 160 vende. Puna e IUCN-së është mbështetur nga mbi 1.000 persona staf në 60 zyra dhe qindra partnerë në publik, OJQ-ve dhe sektorit privat në mbarë botën.

IUCN, Rajoni i Evropës mbulon kontinentin evropian, Rusinë dhe Azinë Qëndrore, dhe përfshin subjektet e Bashkimit Evropian jashtë shtetit. Përfaqësuar nënjë të tretën e anëtarësisë globale, ky është rajoni më i madh i IUCN-së programatike. Katër zyra në Zvicër, Belgjikë, Gjeorgji dhe Serbi bashkërenduan veprimet në rajon. Së bashku ne përpiqemi për të përmbushur synimet tona për një të ardhme të qëndrueshme duke përdorur ekspertizën dhe fuqinë e rrjetit të IUCN globale.

www.iucn.org